



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 33, dt. 08.03.2017

Në mbështetje të nenit 47 të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 08.03.2017, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit "HEC Prishta 1, HEC Prishta 2", në fshatin Prishtë, komuna Çepan-Skrapar me subjekt aplikues shoqëria "HP Prishta 1&2 Energy" sh.p.k..
2. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture:
Projekt Mirëmbajtje te "Kalaja në fshatin Prishtë", sipas projekt-preventivit hartuar nga specialistët e DRKK Berat.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR I DELEGUAR

ARTA DOLLANI